



## MI - 630 AQUASEAL UV



PAKETIMI

8kg + 25kg



RAPORTI I PERZIERJES

8kg leng / 25 kg pluhur



KONSUMI

1.7 kg/m<sup>2</sup>

### Përshkrim

MI-630 AQUASEAL UV është një përbërës hidroizolues shumë fleksibël, rezistent ndaj rrezeve UV, me rezistencë të lartë ndaj kripërave për aplikime të brendshme dhe të jashtme, i përbërë nga përbërës të lëngshëm me bazë polimeresh emulsioni dhe pluhur çimento.

### Fushat e Aplikimit

- Hidroizolim i pishinave, banjove, dusheve, ballkonëve, tarracave para shtrimit të pllakave qeramike.
- Hidroizolim i elementeve nëntokësore të betonit si themelet, muret mbajtëse dhe muret e bodrumit.

### Vetitë

- Rezistent ndaj UV.
- Ngjitje e shkëlqyer në të gjithë betonin dhe mura-turën.
- Aplikohet si në sipërfaqe horizontale ashtu edhe në vertikale.
- Parandalon karbonizimin në beton.
- Rezistent ndaj ngrirje-shkrirjes.
- Shumë rezistent ndaj joneve të klorurit.
- Parandalon betonin kundër ngrirjes së kripërave si kalciumi dhe kloruri i natriumit, uji i detit dhe gazi i dioksidit të karbonit.
- Lehtë për t'u aplikuar ose me furçë, rul ose mistri.

### Udhëzimi për Zbatimin e Produktit

- Sipërfaqja duhet të pastrohet nga mbetjet që mund të pengojnë ngjitjen.
- Duhet treguar kujdes që sipërfaqja të jetë e trajtuar dhe të jetë e qëndrueshme në funksion të qëllimit të përdorimit.
- Pjesët e pasheshuara, deformuara mbi sipërfaqen ku do të zbatohet produkti (nëse ka), duhen trajtuar me MATIART.

-Sipërfaqja ku do të përdoret produkti duhet të ruhet një ditë nga rrezatimet e diellit, shiu dhe pluhuri dhe zbatimi nuk duhet bërë direkt në rrezet e diellit. Para se filloni të përdorni produktin sipërfaqja ku do të zbatohet duhet të laget me ujë deri sa të ngopet. Bëni kujdes që të mos krijohen pellgje uji.

-Komponentin pluhur 25 kg. derdheni me kujdes mbi komponentin e lëngshëm 8L dhe përziejini mirë në mënyrë që të mos mbeten tokla.

Rekomandohet që përzierja të bëhet me mikser me xhiro më të ulëta se 500 xhiro në minutë.

-Masa e përgatitur duhet lënë 5 minuta për t'u bërë gati për përdorim dhe duhet përzier përsëri 1-2 minuta para zbatimit.

-Masa e përgatitur në nënshtresë duhet të zbatohet me 2 kate (duar) me rul ose me furçë. Në varësi edhe të temperaturës për të kaluar në dorën e dytë duhet pritur 5 deri në 6 orë. Duart duhen dhënë në drejtim vertikal me njëra-tjetrën. Një trashësi në total 2-3 mm do të ishte e mjaftueshme.

-Tek këndet lidhëse të murit me dyshtemenë, vendet ku ka bashkime apo deformime në ambientin ku do të zbatoni produktin duhet të përdorni ngjitës të posaçëm shirit rretë. Në rastet ku mundon ngjitësi shirit rretë, atëherë detajet lidhëse duhen të bëhen ovale dhe produkti duhet të përforcohet me rretë me fibra.

-Masa e përgatitur duhet konsumuar brenda 6 orëve. Kjo kohë mund të shkurtohet në varësi të kushteve të papërshtatshme të mjedisit ku është bërë zbatimi si: temperaturë e lartë, nivel i ulët lagështie, erë. Masa e përzierjes që i ka kaluar koha e përdorimit duhet hedhur poshtë. Pas zbatimit të produktit duart dhe veglat e punës duhen larë me ujë të bollshëm.

- Pasi të jetë bërë zbatimi sipërfaqja duhet ruajtur të paktën për 24 orë nga rrezatimet direkte të diellit, shiu, ngricat dhe era.
- Sipërfaqja e trajtuar me MI-630 AQUASEAL UV duhet të vishet sipër me material mbrojtës si shap, pllaka qeramike.
- Hapësirat ku është zbatuar produkti para se të përdoren ose vishen me materiale të tjera (pllaka) duhet të kalojnë të paktën 3 ditë. Nëse sipërfaqja ku është zbatuar produkti është depo uji atëherë priten 28 ditë për trajtimin e sipërfaqeve me këtë produkt dhe pas trajtimit depoja e ujit lahet me ujë të ngrohtë.
- Konsumi i shkruar këtu është një informacion i përgjithshëm. Mund të ndryshojë në varësi të kushteve të zbatimit dhe veçorive të sipërfaqes

**Jetëgjatësia në Raft**

12 muaj në ambient të thatë dhe ambalazh të pahapur.

**Magazinimi**

- Komponenti i lëngshëm duhet ruajtur ndërmjet temperaturave (+5°C) - (+23°C) dhe në mënyrë që të mos jetë i ekspozuar ndaj rrezeve të diellit.
- Komponenti pluhur të ruhet në vend të thatë dhe thasët të vendosen në stiva e shumta me nga 10 kate.

**SKEDA TEKNIKE** (NË +23°C DHE 50% RH.)

Forma	Pluhur + Lëng
Ngjyra	Gri
Magazinimi	12 muaj nëse ruhet në paketimin origjinal të mbyllur, në një vend të thatë.
Raporti i përzierjes	8kg lëng / 25kg pluhur
Temperatura e aplikimit	(+5°C) - (+35°C)
Koha e punueshmërisë	5 Orë
Forca ngjitesë pas zhytjes në ujë (EN 14891)	≤0.5mm
Koha e pritjes midis shtresave	5-6 Orë
Kapaciteti Hidroizolues	7 bar (positive)
Reagimi ndaj zjarrit	A1
Substanca të rrezikshme	Shiko SDS